



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:193267
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05527648

C.nr.7059/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditëses I.J nga P, e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga R.K, avokat me seli në P, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga A.Q – zyrtare ligjore pranë të paditurës, me objekt kontesti kompensimin e pagave mbi bazën e kualifikimit, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor – publik, me datë 25.03.2024, në prezencën e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, me datë 29.03.2024, mori dhe në të njejtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRËSI si e bazuar kërkesëpadia e paditëses I.J nga P, ashtu që: DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, që paditëses, në emër të kompensimit të diferencës së pagave të pa paguara mbi bazën e kualifikimit në punë për periudhën kohore 01.07.2018 – 06.02.2023, (55 muaj x 55.35 €), për kualifikimin Bachelor në vlerë të 27% të pagës bazë, t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 3,044.25 € (tre mijë e dyzet e katër euro e njëzet e pesë cent), së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë, gjegjësisht data 04.08.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, që paditëses I.J, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 289.00 € (dyqind e tetëdhjetë e nëntë Euro), dhe atë në afat prej 7 ditësh nga ditat e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja I.J nga P, përmes përfaqësuesit të autorizuar, pranë kësaj Gjykate me dt.04.08.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e pagave mbi bazën e kualifikimit. Si në padi, ashtu edhe në parashtresën për plotësimin e padisë dhe në seancën gjyqësore të mbajtur me dt.25.03.2024, ndër tjera ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura në vendin e punës “...”, për më tepër se 10 vite në SHFMU “P” në P. Tutje theksohet se paditësja ka të kryer Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës – Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, me ç’rast ka

marrë titullin Bachelor, ndërsa është licencuar nga Ministria e Arsimit me datën 13.06.2013, andaj mbi këtë bazë i takon kompensimi në emër të avancimit në karrierë dhe zhvillim profesional, ashtu siç parashihet me nenin 7 par.1 pika 1.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 e vlefshme deri me datë 22.01.2021. Më tej pretendohet se e paditura, edhe përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e lartëcekur, nuk e ka bërë kompensimine avancimit në karrierë në vlerë të 27% të pagës bazë, deri në momentin e paraqitjes së padisë. Në parashtrësën për plotësimin dhe precizimin e padisë, të dorëzuar në seancën përgaditore të dt.25.03.2024, është theksuar se përveç Kontratave Kolektive të lartëcekura, kërkesëpadija e paditëses gjen mbështetje edhe në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33, të dt.29.08.2008, respektivisht pikën 3 të këtij Vendimi. Po ashtu, pala paditëse i është referuar edhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, në petitum të kërkesëpadiës ka propozuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpadija e paditëses dhe të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të kualifikimit për periudhën kohore 01.07.2018 – 06.02.2023, në vlerë të 27% të pagës bazë, në emër të shtesës për kualifikim në vlerë prej 55.35 Euro për 55 muaj, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 3,044.25 Euro, me kamatë prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, të specifikuar në parashtrësën e dt.25.03.2024 si dhe në fjalë përfundimtare

E paditura si përmes përgjigjes në padi, të deponuar në Gjykatë me dt.15.12.2022, ashtu edhe në seancën përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, fillimisht mbi bazën e pretendimit se paditësja nuk ka ofruar prova që i ka shterrur të gjitha mjetet juridike para se t'i drejtohet Gjykatës me padi, ashtu siç është e paraparë me nenin 78 par.1 të Ligjit të Punës, duke pretenduar në këtë mënyrë se padia është e parakohshme. Më tej pretendohet se në rastin konkret ekziston edhe parashkrimi i kërkesës, me arsyetim se kërkesatë tilla nga marrdhënia e punës parashkruhen brenda afatit 3 vjeçar. Tutje pretendohet se kompensimetë tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, e po ashtu theksohet se e paditura gjatë përgaditjes së buxhetit nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore për këtë lloj të kompensimit. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.25.03.2024, gjatë procedurës së administrimit të provave, ka administruar provat materiale si në vijim: Licenca e mësimdhënsit, me numër ..., e lëshuar me datë 13.06.2013; Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e dt.15.05.2019; Kontrata e punës për stafin arsimor me numër protokollit ..., e dt.14.09.2019, si dhe lista e pagave nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, me ç'rast ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nga provat e administruara, Gjykatës i rezulton se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti që paditësja është në marrdhënie pune pranë të paditurës, gjegjësisht është e punësuar në vendin e punës "... " në SHFMU "P" në P. Po ashtu, nuk rezulton të jetë kontestues fakti se e njejta realizon pagë mujore bazë në shumën prej 421.00 €.

Nga diploma e lëshuar me dt.15.05.2019, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, në Prishtinë, vërtetohet fakti se paditësja me datë 15.07.2015 i ka mbaruar studimet në Fakultetin e Edukimit - programin “Gjuhë dhe Letërsi Shqipe”, me ç’rast ka marrë titullin “Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe”.

Nga licenca me numër ..., e lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, vërtetohet fakti se paditësja ka fituar licencën e mësimdhënësës së karrierës për periudhën kohore 13.06.2013 – 13.06.2018.

Në raport me bazën juridike të mbështetjes së kërkesëpadisë, Gjykata fillimisht iu referua Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të lidhur me datë 18.04.2017, me rastin e nënshkrimit nga Organizatat e të Punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës), si dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë), e cila Kontratë ka gjetur zbatim për periudhën kohore 18.04.2017 - 21.01.2021.

Dispozita nga neni 7, pika 1.3 dhe 1.4 e Kontratës së lartëcekur, përcakton që: *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.3. Mësimdhënësit me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë; 1.4. Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçare, magjistraturë/master dhe doktoraturë 35% të pagës bazë.”*

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të mbështetjes së kërkesëpadisë, Gjykata po ashtu iu referua edhe Vendimit Nr.01/33, të datës 29.08.2008, të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ku në pikën 3 të këtij Vendimi shprehimisht përcaktohet që: *“Ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillor dhe atë të mesëm bëhet në bazë të kriterëve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës”*. Pika 4 e të njëjtit vendim përcakton që: *“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur: Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagesës bazë prej 27%; Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoratë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%.”*

Së fundmi, Gjykata iu referua edhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A-Su.A, 214/2023, të dt.09.10.2023, specifikisht pikës I të këtij Mendimi, ku përcaktohet: *“Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008.”*

Në arsyetim të këtij Mendimi Juridik është sqaruar se Vendimi i lartëcekur ka qenë në fuqi deri me datën 06.02.2023, (kur edhe është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik Nr.08/L-196), ndërsa tutje është sqaruar edhe fakti se mbështetja e kërkesëpadisë për kompensim mbi bazën e kualifikimit në këtë Vendim nga ana e mësimdhënësve është në shërbim të sigurisë juridike.

Në këtë mënyrë, vlerësimi përfundimtar i Gjykatës konsiston në faktin se paditësja I.J është pajisur me licencë të mësimdhënësës së karrierës me dt.13.06.2013, ndërsa ka fituar titullin “Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe” me dt.15.07.2015. Në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësës për

kompensimin e pagës mbi bazën e kualifikimit përfshin periudhën kohore 01.07.2018 – 06.02.2023, periudhë kjo gjatë së cilës Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/33, i dt.29.08.2008 ka qenë në fuqi, gjegjësisht ka prodhuar efekte juridike. Mbi këtë bazë, e njëjta mund t'i gëzojë benefitet e përcaktuara me Vendimin e lartëcekur, respektivisht të drejtën e përfitimit të ngritjes së pagës bazë në vlerën prej 27% mbi bazën e kualifikimit, të përcaktuar në pikën 4 të Vendimit të lartëcekur.

Në prezencën e rrethanave të lartëcekura, Gjykata vlerëson se paditësja është legjitimuar të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrëdhënia e detyrimit mes palëve ndërgjyqëse, në kuptim të dispozitës nga neni 245 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Mbi këtë bazë, është bërë përlllogaritja në atë mënyrë që fillimisht është përlllogaritur vlera prej 27% e pagës bazë së paditëses (421.00 x 27%), nga e cila përlllogaritje ka dalë shuma prej 113.67 €. Nga shuma e lartëcekur është zbritur shuma në vlerë prej 58.32 €, e cila i është kompensuar paditëses në kuadër të pagës mujore, ndërsa ka ngelur shuma prej 55.35 €. Meqenëse kërkesëpadia e paditëses përfshin periudhën kohore prej 55 muaj, vlera e lartëcekur (55.35) është shumëzuar me numrin 55, nga e cila përlllogaritje Gjykatës i rezulton se paditëses i takon e drejta në kompensim në shumën e përgjithshme prej 3,044.25 € (55.35 x 55 = 3,044.25). Bazuar në këto konstatime, u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke marrë në konsideratë edhe dispozitën nga neni 2 par.1 të LPK-së, e cila përcakton: *“Në procedurë kontestimore gjykata vendosë brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse.”*

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi pretendimet e ngritura nga ana e të paditurës përmes përgjigjes në padi, ashtu edhe në seancën e shqyrtimit kryesor, të cilat përmblihen në disa rrethana:

Sa i përket pretendimit se paditësja nuk ka ofruar prova se i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative para se t'i drejtohet Gjykatës me padi, siç është paraparë me dispozitën nga neni 78 par.1 të Ligjit të Punës, Gjykata vlerëson se lidhur me realizimin e kërkesave të tilla të cilat kanë karakter monetar, nuk është e domosdoshme që i punësuar i t'i shfrytëzojë të drejtat e përcaktuara nga dispozitat e lartëcekura pranë punëdhënësit, pra nuk ka ndonjë pengesë që t'i drejtohet Gjykatës drejtpërdrejtë përmes ushtrimit të padisë.

Në raport me pretendimin e ngritur nga e paditura lidhur me parashkrimin e kërkesës, një pretendim të tillë Gjykata po ashtu e vlerëson të pa themeltë, mbi bazën e këtyre arsyeve: Kërkesa për kompensimin e pagave mbi bazën e kualifikimit përfshin periudhën kohore 01.07.2018 - 06.02.2023, ndërsa padia është parashtruar me datë 04.08.2021. Dispozita nga neni 87 e Ligjit të Punës përcakton: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në rastin konkret, kemi të bëjmë me kërkesë periodike, me ç'raste drejta për paraqitjen e kërkesës për një kompensim të tillë ka filluar të rrjedhë nga muaji gusht i vitit 2018, kur është paraqitur kërkesa e parë, duke vazhduar të rrjedhë për çdo muaj vijues deri në ditën kur është bërë e arritshme kërkesa e fundit, me dt.06.02.2023). Meqenëse nga data kur është bërë e arritshme kërkesa e parë, e deri në në momentin e paraqitjes së padisë nuk ka kaluar afati i përcaktuar prej 3 vitesh, rezulton se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës.

Lidhur me pretendimin se kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, Gjykata vlerëson se e drejta e paditëses për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës, fillimisht është paraparë me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017, e cila buron pikërisht nga dispozitat e Ligjit të Punës, ku në nenin 3 par.1, pika 1.8 e këtij ligji përcaktohet: *“Kontrata Kolektive - marrëveshja ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të të punësuarve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur”*. Në mënyrë më specifike, kushtet lidhur me vlefshmërinë e këtyre Kontratave, janë të përcaktuara me dispozitën e nenit 90 të Ligjit të Punës. Në këtë mënyrë, meqë sipas Kontratës Kolektive të lartëcekur, në njërën anë janë paraparë të drejta për njërën palë, e në anën janë marrë përsipër obligime nga pala tjetër, rrjedh se e drejta e paditëses për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës, në mënyrë indirekte derivon nga dispozitat e Ligjit të Punës. Për më tepër, e drejta për të përfituar një kompensim të tillë për kategorinë e të punësuarve, të cilës i takon edhe paditësja është përcaktuar edhe me një akt tjetër nënligjor – Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të dt.29.08.2008, të cilit Gjykata i është referuar në pjesën e mësipërme të arsyetimit të këtij aktgjykimi. Pretendimin lidhur me mungesën e një linje të veçantë buxhetore për kompensimet e tilla, Gjykata po ashtu e vlerëson pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje, për faktin se një rrethanë e tillë nuk mund të konsiderohet pengesë që paditësja t’i realizojë të drejtat e garantuara me Kontratë Kolektive, dispozitat e së cilës janë të karakterit obligativ, nënkuptohet mbi bazën e plotësimit të kushteve dhe ekzistimit të rrethanave të cilave Gjykata u është referuar më sipër në arsyetim të këtij aktgjykimi. Në këtë mënyrë, pretendimet e ngritura nga ana e të paditurës, Gjykata i vlerësoi pa ndikim në krijimin e një bindje tjetër në raport me vendosjen e kësaj çështje.

Gjykata në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi vendosi edhe lidhur me kërkesën aksesore, duke detyruar të paditurën që shumat e gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguajë paditëses së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data e parashtrimit të padisë në Gjykatë, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Një vendosje e tillë është mbështetur në dispozitën nga neni 382 të LMD-së, e cila parasheh që: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, nga pika II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 452 par.1, 454 par.1 lidhur me nenin 463 par.1 LPK-së, duke e obliguar të paditurën që paditëses t’ia kompensojë shumën e tërësishme të shpenzimeve të nevojshme në vlerë të përgjithshme prej 289.00 Euro dhe atë: 104.00 Euro në emër të përpilimit të padisë, 40.00 Euro në emër ta taksës për padi dhe 135.00 Euro në emër të përfaqësimit nga avokati në një seancë gjyqësore. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve të aprovuara, Gjykata iu referua Tarifës së Odës së Avokatëve (numrit tarifor 6). Përtej kësaj shume, Gjykata vlerëson se palës paditëse nuk i takojnë shpenzimet në emër të parashtrësës për precizim të padisë në vlerë prej 104.00 Euro, për faktin se këto shpenzime nuk janë shkaktuar me fajin e të paditurës, andaj edhe nuk mund edhe t’i ngarkohen.

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të nenit 160 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -

C.nr.7059/21, datë 29.03.2024

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 477 të LPK-së është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.